



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MALLAKASTËR**  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3311 Prot.

Ballsh më, 20.06.2022

**VENDIM**

Nr. 36 Datë 20/06 / 2022

**“PËR**

**PJESMARRJEN E BASHKISË MALLAKASTËR NE SUBJEKTE ME  
KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QELLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE  
TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE  
TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të Nenit 9, dhe të pikës 1 dhe 5, të Nenit 14 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, shkresës me nr. 963/37 Prot., datë 18.05.2022 “Përcillet për njohje Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022”, të VKM nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe perpunimit të ujërave të ndotura”,

**VENDOSI**

1. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, për të negociuar me bashkitë e Qarkut si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për mundësinë lidhjen e marrëveshjes specifike për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i Shoqërisë UK Mallakastër sh.a., që pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia do të jetë aksionare, të vijoje me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionareve të autorizimit për Administratorin e Shoqërisë Aksionare “\_\_\_\_\_” UK për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktore dhe noterial me qëllim transferimit të veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SKP-UK që do të krijohet.

**KRYETAR**

**FITIM BARAJ**